



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 193

Tiranë – E martë, 7 nëntor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 619, datë 1.11.2017	Për caktimin e anëtarit të ekipit përzgjedhës për zgjedhjen e kandidatëve, anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.....	9459
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 620, datë 1.11.2017	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 34, datë 7.1.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për drejtorinë e shërbimeve qeveritare dhe trajtimin e personaliteteve të larta”, të ndryshuar.....	9459
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 1.11.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr. 358, datë 24.4.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e prokurimit të mallrave, punëve e të shërbimeve, në kuadër të veprimtarive të ceremonialit zyrtar”	9460
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 622, datë 1.11.2017	Për përcaktimin e kriterëve dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare në rast vdekjeje, sëmundjeje ose fatkeqësie për punonjësit civilë të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.....	9460
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 623, datë 1.11.2017	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, në lidhje me bashkëpunimin për zhvillimin e masterplanit të gazit të Shqipërisë.....	9461
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 624, datë 1.11.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar.....	9463
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 1.11.2017	Për lirin dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Tiranës.....	9464
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 626, datë 1.11.2017	Për lirin dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Durrësit.....	9464

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 1.11.2017	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Elbasanit...	9464
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 1.11.2017	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Shkodrës...	9465
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 1.11.2017	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Lezhës.....	9465
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 630, datë 1.11.2017	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Kukësit.....	9465
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 631, datë 1.11.2017	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Dibrës.....	9465
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 1.11.2017	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Vlorës.....	9466
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 633, datë 1.11.2017	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Fierit.....	9466
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 634, datë 1.11.2017	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Beratit.....	9466
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 1.11.2017	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Gjirokastrës.....	9466
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 636, datë 1.11.2017	Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut të Korçës.....	9467
Udhëzim i Përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 1181, datë 30.10.2017	Për ngritjen dhe funksionimin e regjistrimit elektronik të subjekteve që marrin masa shtesë të sigurisë publike.....	9467



VENDIM

Nr. 619, datë 1.11.2017

**PËR CAKTIMIN E ANËTARIT TË
EKIPIT PËRZGJEDHËS PËR
ZGJEDHJEN E KANDIDATËVE,
ANËTARË TË KOMISIONIT
KOMBËTAR RREGULLATOR TË
SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË
UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Gerta Lubonja caktohet anëtar i ekipit përzgjedhës për përzgjedhjen e kandidatëve, anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura.

2. Vendimi nr. 251, datë 30.4.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e anëtarit të ekipit përzgjedhës për përzgjedhjen e kandidatëve, anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 620, datë 1.11.2017

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 34, DATË 7.1.1999,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
DREJTORINË E SHËRBIMEVE
QEVERITARE DHE TRAJTIMIN E
PERSONALITETEVE TË LARTA”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7582, datë 13.7.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 34, datë 7.1.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës “g”, të pikës 2, shtohen shkronjat “i” dhe “j”, me përmbajtje:

“i) Ofrimin e shërbimeve të përgjithshme, në Kryeministri. Shpenzimet për këtë shërbim përballohen nga buxheti i shtetit.

Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare mund t’i kërkohet, pjesërisht apo tërësisht, ofrimi /transferimi i këtyre shërbimeve të përgjithshme edhe nga institucionet më të larta të shtetit, si Presidenca apo Kuvendi i Shqipërisë. Shpenzimet për shërbimet e ofruara përballohen nga buxheti i shtetit.

j) Organizimin e eventeve, si dhe të aktiviteteve ceremoniale, publike dhe jopublike, sipas kërkesës, duke trajtuar me përparësi nevojat e Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit. Shpenzimet për këto evente përballohen nga buxheti i vetë institucioneve.”.

b) Pika 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“16. Shpenzimet që kryhen nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, zëvendëskryeministri dhe nënkryetarët e Kuvendit për evente dhe aktivitete ceremoniale, pritje, dreka e darka zyrtare, që jepen nga këto personalitete, si dhe shpenzimet për kafe, që bëhen nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit dhe Kryeministri, përballohen nga fondet e vetë institucioneve që përfaqësojnë autoritetet e lartpërmendura.”.



2. Pozicionet dhe punonjësit aktualë në këto pozicione, në sektorin e shërbimeve të përgjithshme, në Departamentin e Administrimit dhe Shërbimeve, pranë Kryeministrit, kalojnë te struktura e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare. Kategoria e pagave për secilin pozicion të transferuar do të jetë e njëjtë me pozicione të ngjashme në strukturën e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

3. Mjetet, materialet, makineritë, pajisjet, veglat në inventarin e Kryeministrit dhe që i shërbejnë funksioneve të transferuara kalojnë në inventarin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare.

4. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 621, datë 1.11.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 358, DATË 24.4.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MËNYRËN E PROKURIMIT TË MALLRAVE, PUNËVE E TË SHËRBIMEVE, NË KUADËR TË VEPRIMTARIVE TË CEREMONIALIT ZYRTAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të vendimit nr. 420, datë 8.6.2016, “Për miratimin e ceremonialit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, dhe të vendimit nr. 1, datë 10.1.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 358, datë 24.4.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si vijon:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë:

“1. Institucioni i Presidentit të Republikës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Kryeministria,

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare të prokurorjve mallra, punë dhe shërbime, sipas përcaktimeve të ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë dhe të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, në kuadër të organizimit të veprimtarive të veçanta dhe të përditshme me karakter protokollar dhe ceremonial.”.

b) Pika 3 shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Kryeministria dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 622, datë 1.11.2017

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS FINANCIARE NË RAST VDEKJEJE, SËMUNDJEJE OSE FATKEQËSIE PËR PUNONJËSIT CIVILË TË AGJENCISË SË INTELIGJENCËS DHE SIGURISË SË MBROJTJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 58, të ligjit nr. 65/2014, “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësi civil i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM) ose familja e tij, në rast vdekjeje, sëmundjeje të rëndë dhe për një kohë të gjatë ose dëmtimesh të rënda të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore, përfiton ndihmë financiare të menjëhershme, si më poshtë vijon:

a) 6 paga mujore të muajit të fundit, kur vdes;

b) 4 paga mujore të muajit të fundit, kur sëmuret rëndë dhe për një kohë të gjatë, e vërtetuar me raport mjekësor;

c) 3 paga mujore të muajit të fundit, kur njëri nga familjarët në ngarkim të tij vdes ose sëmuret rëndë dhe për një kohë të gjatë, e vërtetuar me raport mjekësor;



ç) 4 paga mujore të muajit të fundit, kur pëson dëmtime të rënda të pronës, si rezultat i një fatkeqësie natyrore.

2. Kur punonjësi civil në detyrë i AISM-së vdes, kjo agjenci organizon ceremoninë e rastit dhe përballon shpenzimet e varrimit, sipas dokumenteve që justifikojnë shpenzimet.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i veçantë në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

4. Procedura dhe dokumentacioni i nevojshëm për dhënien e ndihmës financiare, në zbatim të këtij vendimi, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Mbrojtjes.

5. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 623, datë 1.11.2017

**PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT
TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
AZERBAJXHANIT, NË LIDHJE ME
BASHKËPUNIMIN PËR ZHVILLIMIN E
MASTERPLANIT TË GAZIT TË
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, në lidhje me bashkëpunimin për zhvillimin e masterplanit të gazit të Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË AZERBAJXHANIT NË
LIDHJE ME BASHKËPUNIMIN PËR
ZHVILLIMIN E MASTERPLANIT TË GAZIT
TË SHQIPËRISË**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Azerbajxhanit (më poshtë të quajtura individualisht “Pala”, bashkërisht “Palët”):

duke mbështetur sovranitetin dhe integritetin territorial të njëra-tjetrës, si dhe përpjekjet e ndërsjella që synojnë forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ekonomik dhe energjetik ndërmjet palëve;

duke ritheksuar mbështetjen politike për implementimin e Korridorit Jugor të Gazit dhe duke mirëpritur vendimin përfundimtar të investimeve të Shah Deniz, projekti i fazës së dytë si komponent thelbësor i rëndësishëm për sigurimin e burimit të ri të furnizimeve të gazit nga Republika e Azerbajxhanit në Evropë, duke kontribuar kështu në përmirësimin e sigurisë së energjisë të Evropës;

duke shënuar deklaratën e përbashkët të nënshkruar nga Presidenti i Republikës së Azerbajxhanit dhe Presidenti i Komisionit Evropian në Baku, në janar 2011, e cila krijon kuadrin politik për zhvillimin e Korridorit Jugor të Gazit;

duke pasur parasysh Memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Republikës së Kroacisë dhe Malit të Zi, në lidhje me mbështetjen e tyre dhe bashkëpunimin për realizimin e projektit të tubacionit të gazit Trans-Adriatik dhe projektit të gazsjellësit Jonian-Adriatik, të nënshkruar në maj 2013, në Tiranë, dhe Memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Azerbajxhanit, Republikës së Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Republikës së Kroacisë dhe Malit të Zi, mbi bashkëpunimin për implementimin e Korridorit Jugor të Gazit në Evropën Juglindore, të nënshkruar në dhjetor 2013, në Baku;

duke theksuar rëndësinë e projekteve të gazsjellësit Trans-Anatolian (TANAP), gazsjellësit të Trans-Adriatikut (TAP) dhe gazsjellësit Jonian-Adriatik (IAP), që janë të një interesi strategjik për rajonin e Evropës Juglindore dhe Bashkimit Evropian;



duke nxitur zhvillimin e rrjeteve të reja të transportimit ndërkufitar për gazin natyror, si dhe zhvillimin e infrastrukturës së transportit të gazit natyror në Shqipëri, për të mundësuar që gazi nga Azerbajxhani dhe Kaspiku të hyjë në tregje të reja në Evropën Juglindore, duke përfshirë Shqipërinë;

duke synuar përdorimin e përvojës së zgjeruar të Republikës së Azerbajxhanit në fushën e energjisë, me qëllim ofrimin e asistencës së mëtejshme nga Shoqëria Shtetërore e Naftës e Republikës së Azerbajxhanit (SOCAR) dhe subjektet e tjera kombëtare publike dhe private në Republikën e Shqipërisë, për përgatitjen e një masterplani të gazit për Shqipërinë (GMPA), i cili do të kontribuonte në përmirësimin e mëtejshëm të sigurisë së energjisë të Shqipërisë dhe nxitjen e prosperitetit dhe stabilitetit ekonomik të vendit.

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

SOCAR në koordinimin me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe gazsjellësin e Trans-Adriatikut AG, së bashku me aktorët e interesuar nga Azerbajxhani, do të menaxhojë dhe financojë studimin e fizibilitetit (studimi i fizibilitetit) të GMPA-së. Studimi i fizibilitetit, midis objektivave të tjera, duhet të shqyrtojë opsionet e mundshme të GMPA-së, të identifikojë parakushtet teknike dhe tregtare për zhvillimin e masterplanit kombëtar të gazit, duke përfshirë një udhëzues të detajuar për infrastrukturën në pjesën e poshtme, transportin e gazit natyror dhe rrjetet e shpërndarjes, si dhe infrastrukturën shoqëruese, duke përfshirë, por pa u kufizuar te rezervat e gazit, terminalët e gazit të lëngshëm natyror dhe impiantet e prodhimit të energjisë në Shqipëri. SOCAR do të kontribuojë me ekspertizën dhe përvojën e saj më të mirë për realizimin e suksesshëm të studimit të fizibilitetit brenda grafikut të rënë dakord me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë. SOCAR do të përdorë gjitha përpjekjet e arsyeshme për të filluar studimin e fizibilitetit në kohën që do të bihet dakord ndërmjet palëve (data e fillimit) dhe për përfundimin e tij jo më vonë se njëzet e katër (24) muaj nga data e fillimit.

Neni 2

Me synim garantimin e zbatimit të suksesshëm të studimit të fizibilitetit, palët bien dakord të përgatisin të gjitha kushtet e nevojshme politike, ligjore jodiskriminuese, rregullatore dhe tregtare.

Faqe | 9462

Neni 3

Rezultatet përfundimtare të studimit të fizibilitetit do t'i paraqiten Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit brenda një (1) muaji pas përfundimit të tij. Palët do të bien dakord mbi masa të mëtejshme si rezultat i shqyrtimit të ndërsjellë të rezultatit të studimit të fizibilitetit në një marrëveshje të veçantë.

Neni 4

Për qëllime të garantimit të nivelit të kërkuar të koordinimit me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë gjatë kryerjes së studimit të fizibilitetit, një komitet drejtues, i përbërë nga përfaqësuesit e autorizuar të qeverive përkatëse, SOCAR dhe aktorë të tjerë të interesuar, do të krijohet brenda 3 (tre) muajve nga data e fillimit të studimit të fizibilitetit. Komiteti drejtues do të organizojë mbledhjet e tij sipas rënies dakord, por jo më pak se dy (2) herë në vit, për të diskutuar mbi progresin dhe masat e përcaktuara, Komiteti drejtues mund të krijojë grupe pune sipas nevojës, për trajtimin e çështjeve operacionale individuale.

Neni 5

Pas ekzekutimit të këtij Memorandumi mirëkuptimi, përfaqësuesit e palëve do të takohen dhe bien dakord mbi hapat e mëtejshëm, jo më vonë se një (1) muaj nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 6

Palët do të përdorin përpjekjet e nevojshme për të ruajtur bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë e projektit të gazsjellësit të Trans-Adriatikut mbi veprimtaritë në lidhje me zhvillimin e GMPA-së, në bazë të shtojcës 3 të Raportit të Rakordimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe gazsjellësit të Trans-Adriatikut AG, të datës 13 dhjetor 2012.

Neni 7

Palët mirëpresin Komisionin Evropian dhe aktorë të tjerë që mund të përfitonin nga ky bashkëpunim për ofrimin e mbështetjes dhe pjesëmarrjes së tyre aktive, në bazë të marrëveshjes së ndërsjellë të palëve.



Neni 8

Palët pranojnë se ky Memorandum Mirëkuptimi nuk krijon detyrime ligjore për palët.

Neni 9

Ky Memorandum Mirëkuptimi lidhet për një periudhë prej pesë (5) vjetësh dhe do të hyjë në fuqi datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim të Palëve, nëpërmjet kanaleve diplomatike, pas zbatimit të procedurave të nevojshme të brendshme.

Neni 10

Palët mund t'i japin fund këtij Memorandumi mirëkuptimi nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke dhënë njoftim me shkrim. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të konsiderohet si i pavlefshëm gjashtë (6) muaj pas marrjes së këtij njoftimi.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë Memorandum mirëkuptimi.

Ky Memorandum Mirëkuptimi është hartuar në Tiranë, më 19 dhjetor 2014, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, azerbajxhanase dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllorj autentike. Në rast mospërputhjeje në interpretimin e këtij Memorandumi mirëkuptimi, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Damian Gjikhuri
MINISTRI I ENERJISË DHE INDUSTRIË

PËR QEVERINË E AZERBAJXHANIT
Natig Aliyev
MINISTRI I ENERJISË

VENDIM

Nr. 624, datë 1.11.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 682, DATË 29.7.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR TRANSPORTIMIN E PUNONJËSVE ARSIMORË QË PUNOJNË DHE TË NXËNËSVE QË MËSOJNË JASHTË VENDBANIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21, pika 4, 22, pika 2, 23, pika 2, 24, pika 4, dhe 25, pika 4, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 5, 6, 19 e 28, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të kreut II, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportin rrugor”, të ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 4, e vendimit nr. 682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Në rastet kur njësitë arsimore vendore nuk realizojnë me sukses procedurat e prokurimit publik të shërbimit të transportit të punonjësve arsimorë dhe nxënësve, të parashikuar në pikën 3 të këtij vendimi, njësitë arsimore vendore realizojnë mbulimin e shpenzimeve për shërbimin e transportit të mësuesve, nxënësve e fëmijëve përfitues drejtpërdrejt, nëpërmjet llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë, të përfituesve ose prindërve të nxënësve apo nëpërmjet shërbimit postar, për ato rrethe/zona ku shërbimi bankar mungon apo është jo lehtësisht i aksesueshëm, në përputhje me pikën 4 të këtij vendimi.

Masa e shpenzimeve për llogaritë mbi bazën e numrit të ditëve mësimore, numrit të nxënësve dhe mësuesve që kanë ndjekur mësimin, çmimit mesatar të biletës për linjat ndërqytetëse apo rrethqytetëse të shërbimit të transportit, të



miratuara me vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar, indeksimit të çmimeve të shërbimit të transportit, të botuara çdo vit nga INSTAT-i, si dhe në bazë të akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë arsimore vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 625, datë 1.11.2017

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË TIRANËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Admir Abrija, prefekt i Qarkut të Tiranës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Znj. Suzana Jahollari emërohet prefekt i Qarkut të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 626, datë 1.11.2017

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË DURRËSIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Emiljan Jani, prefekt i Qarkut të Durrësit, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Roland Nasto emërohet prefekt i Qarkut të Durrësit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 627, datë 1.11.2017

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË ELBASANIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Ardit Demiri, prefekt i Qarkut të Elbasanit, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Maksim Malaj emërohet prefekt i Qarkut të Elbasanit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 628, datë 1.11.2017

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË SHKODRËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Paulin Radovani, prefekt i Qarkut të Shkodrës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Çesk Millja emërohet prefekt i Qarkut të Shkodrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 629, datë 1.11.2017

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË LEZHËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Eduard Ndreca, prefekt i Qarkut të Lezhës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Gjergj Prendi emërohet prefekt i Qarkut të Lezhës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 630, datë 1.11.2017

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË KUKËSIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Liman Morina, prefekt i Qarkut të Kukësit, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Zenel Kuçana emërohet prefekt i Qarkut të Kukësit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 631, datë 1.11.2017

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË DIBRËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Ardit Kaja, prefekt i Qarkut të Dibrës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Nexhbedin Shehu emërohet prefekt i Qarkut të Dibrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM**

Nr. 632, datë 1.11.2017

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË VLORËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Etjona Hoxha, prefekt i Qarkut të Vlorës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Flamur Mamaj emërohet prefekt i Qarkut të Vlorës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 633, datë 1.11.2017

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË FIERIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Vasil Bregu, prefekt i Qarkut të Fierit, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Baki Bala emërohet prefekt i Qarkut të Fierit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 634, datë 1.11.2017

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË BERATIT**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Valbona Zylyftari, prefekt i Qarkut të Beratit, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Harilla Dafa emërohet prefekt i Qarkut të Beratit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 635, datë 1.11.2017

**PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Flamur Bime, prefekt i Qarkut të Gjirokastrës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Astrit Aliaj emërohet prefekt i Qarkut të Gjirokastrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



VENDIM
Nr. 636, datë 1.11.2017

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT
TË KORÇËS

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z. Pandi Papando, prefekt i Qarkut të Korçës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Dhori Spirollari emërohet prefekt i Qarkut të Korçës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 1181, datë 30.10.2017

PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN
E REGJISTRIT ELEKTRONIK TË
SUBJEKTEVE QË MARRIN MASA
SHTESË TË SIGURISË PUBLIKE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”, ministri i Brendshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZOJNË:

1. Ngritjen e regjistrit elektronik për evidentimin dhe administrimin e të dhënave të subjekteve që marrin masa shtesë të sigurisë publike, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi, si pjesë përbërëse e tij.

2. Regjistri elektronik shërben si bazë të dhënash qendrore dhe vendore, për subjektet që marrin masa shtesë të sigurisë publike, dhe administrohet nga Policia e Shtetit.

3. Ky regjistër përmban të dhënat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 5, në nenet 6, 8, 9, 15 dhe 16, të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike” dhe është vetëm për përdorim të brendshëm të strukturave të Policisë së Shtetit sipas parashikimeve të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

4. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka akses me të drejtë leximi në regjistrin elektronik për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”, dhe në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Mënyra e regjistrimit dhe administrimit të të dhënave të subjekteve që marrin masa shtesë të sigurisë publike, si dhe funksionimi i regjistrit elektronik përcaktohen sipas procedurave standarde të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

6. Ngarkohen strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Fatmir Xhafaj

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi



RREGISTËR PËR SUBJEKTET QË MARRIN MASA SHITESË TË SIGURISË PUBLIKE

Nr	Subjekti	Lloji I Aktivitetit	Lloji Subjektit		Kategorit e Subjekteve qe detyrohen te marrin masa shtese sigurie				Mjedisi I Subjektit		Administratori I pallatit			Subjekte qe disponojne sisteme sigurie						Subjekti I Licensuar per vendosjeme kamerave	Masat shtese te sigurise				Vertetimi I Sigurise			Inspektimi nga Policia		Masat Administrative								
			Privat	Publik	A	B	C	D	h hapur	h mbyllur	Emri I Administratorit	Adresa e baneses		kamera	Deede	ura kontrolli	CCTV	GPS	Rider		ETL..	KAMER CCTV	Telesonolji e lartez lartez/rider, ura kontrolli, dedektor etj...	Lidhja e alarmit me sallien e komandimit te Policise se Stretit	Pseudonimi I SHPSF-se	Pa	jo	heqja e vertetimit te sigurise	Ripaljsija ,me vertetim sigurie			gjeba	heqje	At-sye e heqjes te vertetimit te sigurise				
1																																						
2																																						
3																																						
4																																						
5																																						
6																																						
7																																						
8																																						
9																																						
10																																						

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë